



Save the Children



Arlis, Latif, Laura

GJITHËPËRFSHIRJA NË KËNDVËSHTRIMIN TONË

Përbledhje esesh, mesazhesh
dhe vizatimesh nga nxënësit e
shkollave 9 vjetare : "Ali Metra",
"31 Korriku", "Urani Rumbo",
"Muhamet Gjollesha", "Agimi",
"Sevasti Qirjazi", "Haki Stërmilli",
"Demir Gashi", "Fadil Gurmani",
"Vasil Belshi", "Njazi Mastori",
"Qemal Mici", "Avni Rustemi",
"Balil Pelari", në kuadër të
aktiviteteve përmbrojtjen e
të drejtave të fëmijëve.

Parathënie

Broshura "Gjithëpërfshirja në këndvështrimin tonë"" është një botim në vazhdën e publikimeve të projektit: "Promovimi i të drejtave të fëmijëve në arsim dhe zhvillimi skolistik i tyre", i cili po zbatohet nga Shoqata "MEDPAK" në bashkëpunim me Save the Children dhe në partneritet me DAR-et përkatës të qyteteve: Korçë, Vlorë, Gjirokastrër, Dibër, Burrel, Elbasan dhe Durrës.

Ky projekt synon përshtirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në nxenje të shkollat e arsimit bazë, sigurimin e arsimimit cilësor për ta dhe reduktimin e diskriminimit dhe formave të tjera të dhunës ndaj këtyre fëmijëve. Për të realizuar të gjitha këto, puna është fokusuar në disa drejtime: në rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të aktorëve përgjegjës për zbatimin në praktikë të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të punonjësve të arsimit, në fuqizimin dhe konsolidimin e ekipeve multidisiplinare në shkolla dhe drejtori arsimore, si dhe në krijimin e një klime mbështetëse e pranuese për fëmijët me aftësi të kufizuara brenda dhe jashtë shkollës. Në këtë kuadër, qeveritë e nxenësve të shkollave të përfshira në projekt kanë organizuar një sërë aktivitetesh me fokus rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të komunitetit shkollor për të kuptuar dhe pranuar "gjithëpërfshirjen në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara". Në përfundim të këtyre aktiviteteve nxenësit e shkollave pjesëmarrëse kanë përcjellë mesazhet dhe qëndrimet e tyre, lidhur me gjithëpërfshirjen, përmes kësaj broshure.

Përpunuuan materialet

Marina Ndrio & Zela Koka

Tiranë, Nëntor 2013

Falenderime

Autorët e kësaj broshure falenderojnë organizatën "Save the Children", e cila mundësoi botimin dhe publikimin e saj, si dhe shoqatën "MEDPAK" për kontributin në ideimin dhe realizimin e këtij publikimi.

Një falenderim i veçantë shkon për mësueset ndihmëse të qeverisë së nxënësve, të shkollave: "Ali Metra", "31 Korriku", "Urani Rumbo", "Muhamet Gjollesha", "Agimi", "Sevasti Qirjazi", "Haki Stërmilli", "Demir Gashi", "Fadil Gurmani", "Vasil Belshi", "Njazi Mastori", "Qemal Mici", "Avni Rustemi", "Balil Pelari", të cilat na kanë udhëhequr dhe mbështetur gjatë punës tonë.

Mirënjojje për të gjithë ata fëmijë me aftësi të kufizuara, në çdo skaj të Shqipërisë që në një mënyrë apo në një tjetër kanë shërbyer si burim frymëzimi për ne dhe që na kanë dhënë mundësi t'a shohim botën ndryshe.

Një falenderim nga zemra për të gjithë ju prindër që keni luftuar e vazhdoni të luftoni me sfidat e jetës që fëmijët tuaj të rriten, edukohen dhe arsimohen si gjithë fëmijët e tjerë. Ne ju premtojmë se do të jemi se bashku në këtë udhëtim të gjatë drejt gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Dhe së fundmi një falenderim i përzemërt për të gjithë bashkëmoshatarët tanë në të gjithë vendin, që mësojnë e edukohen në shkolla gjithëpërfshirëse, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë që gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara të jetë një realitet.

Dy fjalë rreth projektit tonë....

Projekti ynë nuk është ambicioz, as i kushtueshëm financiarisht, por është një projekt që kërkon të skicojë një tjetër realitet, krej të ndryshëm nga realiteti në të cilin jetojmë, kërkon të tregojë një mënyrë tjetër nga ajo me të cilën kemi gjykuar, menduar, komunikuar dhe jemi sjellë ndaj bashkëmoshatarëve tanë me aftësi të kufizuara.

Këtë projekt kemi vendosur t'a zbatojmë ne, nxënësit e shkollave "Ali Metra", "31 Korriku", "Urani Rumbo", "Muhamet Gjollesha", "Agimi", "Sevasti Qirjazi", "Haki Stërmilli", "Demir Gashi", "Fadil Gurmani", "Vasil Belshi", "Njazi Mastori", "Qemal Mici", "Avni Rustemi", "Balil Pelari" të Shqipërisë. Jemi fëmijë nga qytete të ndryshme, por jemi shtetas shqiptar të gatshëm për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie me tregues të një niveli të lartë të civilizimit dhe qytetarisë europiane dhe me vlera të vërteta njerëzore.

Jemi të sigurt se çdo qytetar shqiptar do t'i bashkohet nismës së këtij projekti me kontributin e tij për t'i thënë ndal paragjykimeve, stigmës dhe diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në faqet e kësaj broshure do të gjeni " deklaratën e gjithëpërfshirjes", të nënshkruar nga një grup përfaqësuesish të qeverive të nxënësve në shkollat ku ne mësojmë Përmes kësaj deklarate ne kemi pohuar të gjithë njëzëri dhe në mënyrë unanime se e kemi rrëzuar murin e veçimit dhe i kemi hapur rrugën gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë dhe në shoqëri. Përmes verdiktit tonë kemi projektuar shoqërinë e së nesërmes, një shoqëri demokratike dhe liberale, një shoqëri pa dhunë, ku çdo fëmije ka të drejtë të arsimohet, të trajtohet si një qënie me vlera dhe potenciale, një shoqëri ku të qenit ndryshe konsiderohet si pasuri e saj.



Kjo është deklarata jonë, dhe njëkohësisht deklarata e të gjithë shqiptarëve që duan të projektojnë të ardhmen e shoqërisë së tyre bazuar mbi vlera të vërteta njerëzore. Na mbështhesni në këtë rrugëtim të gjatë.

Nënshkrimi i kësaj deklarate mund të bëhet përmes shumë mënyrave: duke mos i etiketuar individët me aftësi të kufizuara si njerëz me të meta, si të paaftë, duke mos i quajtur "sakat", "të sëmurë", duke treguar respekt për vlerat dhe kapacitetet që këta njerëz kanë, duke mos e kthyer kokën pas për të parë një fëmijë me "sindrome" doën" që kalon në rrugë dhe duke mos pëshpëritur shprehjen "sa gjynah", "i shkreti", sa "keq", duke e ngritur zërin kur të drejtat e tyre shkelen e dhunohen, duke i konsideruar si pjesë të së "sotmes", dhe burime të së "nesërmes", duke aprovuar buxhete që marrin në konsideratë nevojat e tyre specifike, duke hartuar politika që adresojnë

problemët e tyre, duke ndërtuar kurrikula mësimore gjithëpërfshirëse, duke ndërtuar shkolla dhe ndërtesa që mundësojnë lëvizjen e lirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke i menduar si ‘pjesë të së tjerës’, duke i thënë “ndal” veçimit të tyre .

Ne jemi të bindur qe numri i nënshkruesëve të kësaj deklarate do të rritet pambarimisht, disa do ta nënshkruajnë në mendjen e tyre, disa në zemrën e tyre dhe të tjerë në sjelljen dhe qëndrimin e tyre në jetën e tyre të përditshme.

FIRMOS DHE TI....



Autorët

MESAZHI YNË

Tungjatjeta Shqipëri!

Njerëz zgjohuni, ka lindur një ditë e re. Edhe pse jam një pjesë fare e vogël e kësaj bote të madhe, dua të përcjell fuqishëm mesazhin tim: Luftoni për drejtësinë, përpikuni që çdo fëmijë të arsimohet, shbangni veçimin, synoni "gjithëpërfshirjen e çdo fëmije në shkollë dhe në shoqëri".

Eljanos Kasaj, Shkolla "Avni Rustemi", Vlorë

E duam Shqipërinë të ngjashme me shtetet e tjera europiane, ku gjithëpërfshirja është ngritur mbi themele të forta dhe është një realitet i pakthyeshëm dhe për këtë kërkojmë angazhimin e prindërve, përkushtimin e mësuesëve, vullnetin e politikbërësve, mbështetjen e bashkëmoshatarëve tanë.

Klienti Toska, Shkolla "Njazi Mastori", Durrës

Të gjithë së bashku mund t'ia dalim,

Ne duam të jetë një e nesërme ku dhuna, abuzimi, paragjykimi dhe diskriminimi t'ia lënë vendin tolerancës, pranimit, mbështetjes, mosdiskriminimit.

Suada Heti, Shkolla "Ali Metra", Burrel

TË SHOHËSH NDRYSHE

Ata janë si ne

Ata janë si ne dhe ne si ata

të gjithë jemi njerëz me ndjenja e dëshira të mëdha.

Të gjithë jemi njerëz, njerëz të një toke

duhet ta duam njëri - tjetrin se jemi pjesë e kësaj bote.

Nuk ka rëndësi si je ti, si jam unë,

mund të jemi të ndryshëm, por të barabartë,

Mund të jemi të ngjashëm por të veçantë.

Arbias Pepa, Shkolla "Fadil Gurmani", Elbasan




Rino Beva Hani
Dante Gashi "7"

Nuk ka asgjë "të ndryshme"
midis nesh, jetojmë të
gjithë së bashku, në një
botë, ku askush nuk është i
përsosur.

Anxhela Basha
Shkolla "Fadil Gurmani"
Elbasan

Ti nuk je ajo "karrige e
ftohtë me rrota", ti je
qënia njerëzore që
meriton respekt!



Altea Kulla

Përse fëmijët me aftësi të kufizuara identifikohen nga
karrigia e tyre me rrota, nga paterica që mbajnë në
duar, nga e folura apo nga tiparet e tyre? A nuk jemi të
gjithë "njerëz"? Përse ky paragjykim, apo është
diskriminim, ndoshta është dhe stigmatizim. Nuk ka
shumë rëndësi. Unë dua t'a quaj atë një fëmijë me të
drejta të barabarta, me veçantitë e tij, me aftësitë që
ka. Kjo duhet të jetë gjuha jonë.

Fabjona Markja, Shkolla "Demir Gashi"
Peshkopi

Dora e ngrohtë

Jeta është e mbushur me sfida, shpesh njeriu nuk ka asgjë në dorë për të ndryshuar rrjedhën e fatit të tij. Disa fëmijë e kanë të vështirë të kryejnë aktivitetet e jetës së përditshme për shkak të problemeve që kanë. Por pavarëisht kësaj fëmijët me aftësi të kufizuara kanë dëshirë të luajnë si ne, të mësojnë në të njëjtat shkolla së bashku me ne, por shpesh këto dëshira që janë njëkohësisht edhe të drejta nuk realizohen, pse vallë ndodh kështu? Sepse ne "të tjerët" shpesh nuk arrijmë të shohim brenda botës së tyre, nuk arrijmë të dëgjojmë zërin e tyre, nuk përpinqemi që ata të jetojnë "si ne". Shumë prej nesh janë vetëm spektatorë, duke mos bërë asgje që jeta e këtyre fëmijëve të marrë një kuptim, që ëndrrat e tyre të bëhen realitet. Sa shpesh "dora jonë" është një "dorë e ngrohtë" për këta fëmijë, sa herë zëri ynë i ka ftuar ata të jenë pjesë e jona, në cilat raste kemi bërë diçka që lotët e tyre të ndalen? Ata kanë nevojë për ne, po aq sa dhe ne kemi nevojë për ta, Mos e harroni këtë!



Ledina Nanaj, Shkolla "Qemal Mici"

Jurgeta Gërveshi
Shkolla: "Muhamet Gjollesha", Lazarat, Gjirokastër

TË MENDOSH NDRYSHE

Ata janë si ne

Barazia është një e drejtë njerëzore. Të gjithë jemi të barabartë pavarësisht dallimeve tona. Çfarë duhet të bëjmë që të ndryshojmë mentalitetin, i cili na ka penguar që t'a shohim ndryshimin ndërmjet nesh si një vlerë, si një "pasuri"? Si mund t'a shembim murin që na mban të veçuar? Barazia është e vetmja mënyrë që çdo kush të vlerësohet dhe trajtohet duke mos u nisur nga problemi apo vështirësia që ai/ajo mund të ketë. E çfarë bëjmë ne që barazia të jetë e dukshme, e prekshme? Le të themi se "të gjithë jemi të barabartë", le të mendojmë se askush nuk ka të drejtë të trajtojë disa fëmijë ndryshe, vetëm se kanë një aftësi të kufizuar, le të ndihemi "të gjithë njësoj", sepse qelli, dielli dhe toka na përkasin të gjithëve.

Megi Iskurti , Shkolla: "Demir Gashi"

Si do të ishte bota nëse nuk do të kishte fëmijë me aftësi të kufizuara, e vështirë për tu perceptuar, ndoshta nuk do mësonim kurrë të mbështesnim, të pranonim, të mos paragjykonim. Jetës do t'i mungonin tingujt e melodive të ndryshme, shumëllojshmëria e luleve të pranverës.....

Nxënës, Shkolla:"Haki Stërmilli"

TITULLIXXXXXXXXXXXXXXXXX


Arsimimi eshtë fjala kuptimplotë që na jep mundësinë të gjithëve të aftësohem për tu përballur me jetën. Kjo fjalë eshtë sinonimi i jetës së çdo fëmije. Por në botë ka edhe fëmijë që nuk e njohin kuptimin e fjalës "arsimim". Për ta shkolla, arsimimi mbetet një ëndërr e madhe që ata shpresojnë të bëhet realitet. Në sytë e tyre ka lotë, brengë, keqardhje. Përse ata nuk mund të arsimohen sikurse edhe fëmijët e tjerë? Çdo fëmijë ka të drejtë të veshë uniformën shkollore, të ulet në bankat e shkollës, pranë bashkëmoshatarëve të tij, të marrë dijet që i nevojiten. Çdo fëmijë duhet të ketë librin në dorë, të shohë kaltërsinë e qillit nga dritarja e klasës së tij dhe të kuptojë se ëndrrat bëhen realitet. Të gjithë fëmijët në botë pavarësisht dallimeve që mund të kenë duhet të "arsimohen", të përgatiten për t'u përballur me jetën, sepse ne fëmijët jemi e ardhmja e shoqërisë.

Zhensila Xhelilaj
Shkolla "Avni Rustemi", Vlorë



TË SILLESH NDRYSHË

T'i themi "ndal" bullizmit
Nxënës, Shkolla "31 Korriku"



Çfarë dimë ne për njerëzit me aftësi të kufizuara? Asgjë për aq kohë sa nuk dimë si duhet të sillemi me ta. Çfarë duhet të mësojmë rrëth tyre? Ata janë të barabartë sikurse dhe ne.

Çfarë duhet të zbulojmë për ta? Vlerat dhe kapacitetet e tyre. Ne ju kemi thënë shumë herë atyre "ju nuk mundeni". Ata na thonë çdo ditë "ne mundemi".

Çfarë duhet të ndryshojmë? Qëndrimet tona, sjelljen ndaj tyre, mënyrën e komunikimit, pritshmëritë rrëth tyre.

Le ta provojmë!

Rei Dunja, Shkolla "Fadil Gurmani", Elbasan

Të shembim "murin e veçimit"
Nxnës, Shkolla "Qemal Mici"

Të gjithë jemi njësoj , të barabartë!



Rinoi: Eneida
Shkollë: Shkolla "Demir Gashi"
Klasa: 3^a
Qyteti: Peshkopi

Si unë dhe ti jemi të barabartë
në shoqëri

Klevi Spahiu, Shkolla "Demir Gashi"
Peshkopi

Në familje, fëmijët me aftësi të kufizuara nisin rrugëtimin e parë drejt gjithëpërfshirjes .

Belson Shulku
Shkolla: "Demir Gashi" Peshkopi




Ata nuk duan të ndjenë shpërfilljen, dhe as të diskriminohen, nuk duan të quhen "të paaftë", ata kanë nevojë për dashuri, mbështetje, shpresë, ata dhe ne jemi e ardhmja e këtij vendi.

Xhuliana Hysa, Shkolla: "Njazi Mastori"

Durrës

Fëmijët janë e tashmja



Punoi : VII^a
Griselda Taçë

dhe e ardhmja!

Mbroni të dregtate tyre!


Griselda Taçë

Përpiku që me sjelljen dhe qëndrimin tend të bësh fëmijët me aftësi të kufizuarat të ndjehen "të veçantë", "të pa krahasueshëm", "të barabartë".

Xhejsi Colja
Shkolla: "Vasil Belshi", Shtërmend, Elbasan

TË FLASËSH ME ZËRIN E NGJYRAVE DHE ME MAGJINË E PENELIT





E ardhmja = Gjithëpërfshirje



Adresa: Rruga: "Sh.Ishmi", Pallati 38,
Shkalla1, Apt 2,Tirane
Tel : ++ 355 4 23 45 028
Mobile : 069 22 08 985 / 068 25 78 002
E-mail : info@medpak.org
website: www.medpak.org



Save the Children

Rr. "Komuna e Parisit", Lagjia 8,
Pallatet 1 Maji, Vila "Lami"
P.O. Box 8185
Tel: +355 4 2261840 /
+355 4 2261929 /
+355 4 2266227
Fax: +355 4 2263 428
E-mail: info.albania@savethechildren.org
Web Page: <http://albania.savethechildren.net>